



C.nr.2884/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Adnan Konushevci, në çështjen juridike kontestuese të paditësit-propozuesit për masë të sigurisë Mejdi Bektashi nga Prishtina, Rruga "Anton Çeta", Nr.14, të cilin sipas autorizimeve e përfaqësojnë Hamdi Podvorica dhe Arsim Billalli, që të dy avokat nga Prishtina, kundër të paditurës-kundërshtares së sigurimit OJQ "ADMOVERE" me seli në Prishtinë, Lagjja Ulpiana, C15, Hyrja 10, Nr.6, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Rina Kika, avokate nga Prishtina, Rruga "Miss Edith Durham", B1, Hyrja 1, Nr.11, me objekt kontesti, shpifje dhe fyerje, duke vendosur me propozim për caktimin e masës së sigurimit, në seancën e mbajtur në prani të ndërgjyqësve, përfaqësuesve të tyre, me datë 29.10.2018, dhe pas deponimit të garancionit financiar nga propozuesi, të caktuar nga kjo gjykatë sipas aktvendimit C.nr.2884/2018 të datës 30.10.2018, me datë 08.11.2018, mori këtë:

AKTVENDIM

I. APROVOHET propozimi i paditësit-propozuesit të sigurimit Mejdi Bektashi nga Prishtina, për caktimin e masës së sigurisë, **CAKTOHET** masa e sigurimit dhe i **NDALOHET** të paditurës - kundërshtares të sigurimit OJQ "ADMOVERE" me seli në Prishtinë, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, t'i përsëritë në të ardhmen sjelljet e publikimit, deklaratat, njoftimin apo informacionin, në raport me personalitetin e propozuesit të sigurimit, lidhur me studimin "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", vetëm në pjesën e studimit, që ka të bëjë me propozuesin.

II. DETYROHET e paditura-kundërshtarja e sigurimit OJQ "ADMOVERE" me seli në Prishtinë, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, që ta tërheqë nga publikimi-qarkullimi i mëtejshëm, studimin me emërtim "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", nga mediat e shkruar, elektronike, web-faqe të internetit dhe në rrejte sociale, vetëm pjesën e studimit që ndërlidhet me personalitetin e paditësit-propozuesit, deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate, nën kërcënim të pasojave ligjore.

III. Ky Aktvendim menjëherë do të dorëzohet, palëve ndërgjyqëse dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi-propozuesi i sigurimit, në këtë gjykatë ka ushtruar padi me datë 01.10.2018, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, sepse pa caktimin e një mase të sigurisë në këtë rast sipas propozuesit do të dëmtohet edhe mëtej personaliteti i tij ngase publikimi i një studimi me

emërtim “Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student”, në të cilin studim propozuesi gjendet në mesin e profesorëve të UP-së, ku kundërshtarja e sigurimit thekson: “Rasti Mejdi Bektashi, në shkurt të vitit 2007, Gazeta “Exspress” boton një artikull me titull “Shumë plagjiaturë”, për librin “Ekonomia” të autorëve Mejdi Bektashi dhe Nysret Gacaferri, ku pjesa me e madhe e këtij libri sipas këtij shkrimi, është shkruar duke vjedhur nga libri i autorëve botëror Paul Samuelson dhe William Nordhaus”. Mëtej propozuesi i sigurimit thekson se ky studim i kundërshtarit të sigurimit është i paqëndrueshëm në pjesën që ka të bëjë me propozuesin sepse organi më i lart akademik Senati i UP-së, në vitin 2007, e ka formuar një komision profesional, për të hartuar dhe analizuar një raport me shkrim, lidhur me pretendimet e botuar në Gazetën “Express” të vitit 2007, me titull “Shumë plagjiaturë”, në librin ekonomia. Senati i UP-së, me vendimin me nr. 1/191 i datës 10.05.2007, ka konstatuar se libri “Ekonomia”, nuk është plagjiat, siç ishte botuar në shkrimin e muajt shkurt të vitit 2007 nga Gazeta “Express”. Propozuesi i sigurimi pretendon se pa asnjë dyshim mund të vërtetohet se kundërshtarja e sigurimit gjatë publikimit të lajmeve të rrejshme e ka ditur se janë duke publikuar një lajm me përmbajtje të porositur dhe të pavërtetë. Me propozim për gjykatën që të aprovohet në tërësi propozimi për masë të sigurisë dhe ti ndalohet kundërshtares të sigurimit, t’i përsëritë në të ardhmen sjelljet e publikimit, deklaratat, njoftimin apo informacionin, në raport me propozuesin e sigurimit, lidhur me studimin “Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student”. Të detyrohet kundërshtarja e sigurimit që ta tërheqë nga publikimi-qarkullimi i mëtejshëm, studimin me emërtim “Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student”, nga mediat e shkruar, elektronike, web-faqe të internetit dhe në rrejte sociale, deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë.

Kundërshtarja e sigurimit si në përgjigje në masë as, në seancën e mbajtur dhe në fjalën përfundimtare nëpërmes përfaqësueses të saj, ka theksuar se raporti i publikuar me emërtim “Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student”, nuk ka pas për qëllim ta dëmtoi askënd por qëllimi i këtij studimi ka qenë radhitja e të gjitha rasteve të plagjiaturës të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, për të cilët është raportuar në media për gjatë viteve, duke filluar nga viti 1985, e deri në rastin e fundit të publikuar në media i vitit 2016. Kundërshtarja e sigurimit ka theksuar se burim kryesor për pjesën e raportit që përmendet rasti i paditësit-propozuesit, ka qenë artikulli i datës 04.02.2007, me titull “Shumë Plagjiaturë”, të botuar në Gazetën “Express”. Kjo gazetë asnjëherë nuk e ka publikuar përgënjeshttrimin në lidhje me këtë artikull dhe propozuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që e vërteton se kundërshtarja e sigurimit, ka qenë në dijeni për vendimin nr. 1/191 i datës 10.05.2007. Kundërshtarja e sigurimit pretendon se deklarata e saj gëzon imunitet, bazuar në nenet 7, 9 dhe nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, sepse e paditura nuk është autore e artikullit të publikuar në Gazetën Express, në shkurt të vitit 2007, me titull “Shumë plagjiaturë”, por vetëm e ka cituar një deklaratën tashmë e botuar nga viti 2007. Lidhur me pretendimin e propozuesit të sigurimit që ti ndalohet kundërshtares së sigurimit publikim i deklaratave, prononcimi, njoftimet, informacionet i raporteve në të ardhmen dhe fshirjen e publikimeve kundërshtarja e sigurimit konsideron se është cenim i drejtpërdrejt i lirisë së

shprehjes që mbrohet me nenin 40 të Kushtetutën së Republikës së Kosovës. Kundërshtarja e sigurimit mëtej thekson se nuk janë plotësuar asnjëra nga dy kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 297 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), andaj i propozon Gjykatës që propozimi për caktimin e masës së sigurisë në këtë fazë të procedurës të refuzohet si i pabazuar ngase kundërshtarja i sigurimit nuk ka pas për qëllim që ta dëmton askënd me rastin e hartimit dhe publikimit të studimit-hulumtimit lëndor.

Gjykata, pas që bëri shikimin, vlerësimin e shkresave të lëndës dhe pas dëgjimit të ndërgjyqësve në cilësinë e palëve në procedurë, ka ardh në përfundim se propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, në këtë rast është i bazuar për këto arsye:

Gjykata, bazuar në nenin 304 paragrafi 3 të LPK-së, ka vlerësuar se propozuesi i sigurimit e ka treguar kërkesën për të cilën e bënë propozimin e masës së sigurisë, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Poashtu propozuesi i sigurimit i'ka treguar edhe faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia si dhe ka propozuar mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim ngase propozimit i'ka bashkangjitur: Vendimin me Nr. 1/191 të datës 10.05.2007 i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Faqen nr.2 dhe faqen nr.43 të studimit-hulumtimit të publikuar nga kundërshtarja e sigurimit me datë 25.09.2018, me emërtim "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", komunikimin me Postën Elektronike nëmes të propozuesit dhe të portalit "Kallxo.com" si dhe publikimin e hulumtimit-studimit, të punuar nga kundërshtarja e sigurimit, në web-faqen e portalit "Kallxo.com".

Nga vendimi me Nr. 1/191 i datës 10.05.2007, i lëshuar nga UP-ja, gjykata ka konstatuar se botimi me shkrim në Gazetën "Express" i datës 04.02.2007, me titull "Shumë Plagjiaturë", që ndërlidhet me Librin "Ekonomia, botimi i dytë i plotësuar, autorëve Dr.Sc. Mejdi Bektashi (në këtë procedurë propozues i sigurimit) dhe Mr.Sc Nysret Gacaferri, botuar në vitin 2005, në Prishtinë nga Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës, nuk është plagjiat i librit në gjuhen kroate "EKONOMIJA", i autorëve Paul A. Samuelson dhe Wilijam D. Nordhaus, botuar në vitin 1992.

Me faqen nr.2 dhe faqen nr.43, të studimit-hulumtimit me emërtim "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", gjykata ka konstatuar se studimi është i botuar nga kundërshtarja e sigurimit, në të cilin studim, në mesin e 16 pjesëtarëve, të stafit akademik të UP-së, për të cilët është raportuar në media për gjatë viteve, për plagjiatura është edhe emri i propozuesit të sigurimit, i renditur si rasti 12.

Nga deklarata e propozuesit të sigurimit, të dhënë në cilësinë e palës në procedurë, në seancën e datës 29.10.2018, gjykata ka vlerësuar se propozuesi i sigurimit nga dita e publikimit të hulumtimit-studimit lëndor nga ana e kundërshtares së sigurimit, ka pas fyerje të ndryshme në kushtet e vendit tonë. Propozuesi i sigurimit e njofton Gjykatën se drejtori Shkëlzen Gashi i OJQ "ADMOVERE", në emisionin "Puls" të televizionit "KTV" me datë 15.10.2018, ka bërë gjykim

publik para qindra e mijëra shikuesve, me fakte dhe dëshmi të rrejshme, që sipas propozuesit të sigurimit i vetmi qëllim ka qenë të pengohet propozuesi i sigurimit në avancimin e tij akademik në institucionin ku është duke punuar. Propozuesi i sigurimit mëtej deklaroi se nga këto paraqitje publike të kundërshtares së sigurimit dhe disa hulumtuesve të tjerë, propozuesi i sigurimit ka pas përkeqësuar edhe të gjendjes shëndetësore, duke ja bashkangjitur shkresave të lëndës edhe një raport mjekësor të datës 27.10.2018.

Nga deklarata e drejtorit-themeluesit të OJQ “ADMOVERE”, (kundërshtarë e sigurimit në këtë procedurë) e dhënë në seancën e datës 29.10.2018, në cilësinë e palës në procedurë, gjykata vlerëson se qëllimi i hulumtimit-studimit të kundërshtares së sigurimit nuk ka pas për qëllim ta lëndoi askënd, mirëpo qëllimi ka qenë me i mbledh rastet e publikuara në media si plagjiaturë, duke filluar nga viti 1985. Kundërshtarja e sigurimit deklaroi se në asnjë mënyrë nuk ka pas për qëllim që ta pengoi avancimin e ndonjë profesori në institucionin ku punon, e as propozuesin e sigurimit, sepse siç shihet nga studimi ka pas raste të publikimit që personat kanë dal në pension dhe ka raste ku edhe kanë vdekur. Qëllimi i këtij hulumtimi-studimi, në këtë pjesë të studimit, ka pas për qëllim mbledhjen e të gjitha rasteve të publikuar në media deri me tani që kanë të bëjnë me plagjiaturë.

Gjykata, nga shkresat e lëndës siç janë të vlerësuar më lart rezultoi se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës së tij, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 297 paragrafi 1 pika a), e Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), në të cilën përcaktohet se: *” në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij”*.

Gjykata, vlerëson se ekziston rreziku, për realizimin e të drejtës subjektive nga paditësi-propozuesi i sigurimit, pa lëshimin e masës së sigurisë në këtë rast, ngase do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, sidomos në rast se kundërshtarja e sigurimit do të përsërisë veprimet e tilla në të ardhmen lidhur me çështjen lëndore, bazuar në nenin 297 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në të cilin përcaktohet se: *“Një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj”*.

Gjykata me rastin e vendosjes në këtë rast, lidhur me propozim e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, ka marr parasysh pretendimet e kundërshtares së sigurimit se “liria e shprehjes” është e garantuar me nenin 40 paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i

cili pretendim është i qëndrueshëm ngase liria e shprehjes garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ashtu siç edhe ka deklaruar kundërshtarja e sigurimit. Mirëpo liria lart cekur nuk është absolute, sikurse nuk është absolute edhe asnjë e drejtë tjetër në kuptimin e plotë, prandaj mund të ketë restriksione apo kufizime ngase e njëjta mund të kufizohet me ligj, siç përcaktohet me nenin 40 paragrafi 2 i të njëjtës Kushtetutë dhe me nenin 10 paragrafi 2 te Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (amenduar sipas protokollit nr. 11 dhe e shoqëruar nga protokollit shtojcë dhe protokollit nr. 4, 6, 7, 12 dhe 13).

Në rastin konkret liria e shprehjes, është e kufizuar, bazuar ne nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, ngase personi përmes procedurës gjyqësore ka të drejtën që kërkoj, që të ndalën shpifjet dhe fyerjet dhe të përsëriten ato në të ardhmen, të tërheqin informacionet shpifës dhe fyese ndaj personalitetit të tij. Andaj, gjykata pasi që ka vlerësuar si të bazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, që është vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktvendimi, ku kundërshtares së sigurimit ju është ndaluar t'i përsëritë në të ardhmen sjelljet e publikimit, deklaratat, njoftimin apo informacionin, në raport me personalitetin e propozuesit të sigurimit, lidhur me studimin "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", vetëm në pjesën e studimit, që ka të bëjë me propozuesin, e cili studim është objekt lëndor në raport me pjesën e propozuesit të sigurimit, deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate. Gjykata vlerëson se kjo nuk është kufizimi i lirisë së shprehjeje e as ndonjë ndëshkim ndaj kundërshtares së sigurimit, por është një preventiv që të përmbahet nga veprimet e tilla, lidhur më këtë çështje lëndore, derisa të vendoset me vendim të formës së prerë për të njëjtën.

Prandaj nga te gjitha arsyet e theksuara më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 297, lidhur me nenin 142 paragrafi 5 të LPK-së, lidhur me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, gjykatë ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr.2884/18 datë 08.11.2018

Udhëzim Juridik: *Kundër këtij aktvendimi kundër propozuesi i masës së sigurimit, ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit.*

